

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Nesrin Lushta, kryetare, Emine Mustafa dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit R.L., nga fshati H., komuna e K., për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPPK, duke vendosur përkitazi me kërkesat e mbrojtësve të dënuarit për mbrojtjen e ligjshmërisë, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore – DKR Gjilan, PKR.nr.265/2014 datë 8.3.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.457/2017 datë 24.10.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 17 prill 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësve të të dënuarit R.L., anulohen aktgjykimi i Gjykatës Themelore – DKR Gjilan, PKR.nr.265/2014 datë 8.3.2017 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.457/2017 datë 24.10.2017 dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore – DKR Gjilan, PKR.nr.265/2014 datë 8.3.2017, i dënuari R.L. është shpallur fajtor për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPPK dhe është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqindetëdhjetë) ditësh, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak prej 24.9.2012 gjer më 19.11.2014. Është detyruar që të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 50 €, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.457/2017 datë 24.10.2017, ka refuzuar ankesën e mbrojtësve, ndërsa aktgjykimin e shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjytimeve, kërkesën e përbashkët për mbrojtjen e ligjshmërisë kanë paraqitur mbrojtësit e të dënuarit, Sh.P. dhe S.R., avokat nga Gj. dhe kërkesën tjetër mbrojtësi A.D., avokat nga M., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor me propozim që të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim ose të ndryshohen ashtu që i dënuari të lirohet nga akuza.

Prokurori i Shtetit të Kosovës me parashtresën KMLP.II.nr.232/2017 datë 11.12.2017, ka dhënë përgjigje në kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë duke propozuar që të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në kuptim me dispozitën e nenit 345 par.1 dhe 346 par.1 të KPPK dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesat konstatoi se:

Kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë janë të bazuara.

Në kërkesën e tyre të përbashkët, mbrojtësit e të dënuarit Sh.P. dhe S.R., avokat nga Gj., potencojnë se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 1.12 të KPPK, sepse dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë është i pakuptueshëm meqë në të nuk janë specifikuar veprimet konkrete të veprës penale si elementi i dashjes. Paqartësia tjetër ekziston në mes të dispozitivit dhe arsyetimit lidhur me periudhën inkriminuese meqë në dispozitiv qëndron 2013-2014 ndërsa në arsyetim 2 nëntor 2011 deri në 2 nëntor 2014 e që aktgjykimin e bëjnë kontradiktor.

Ndërsa, mbrojtësi i të dënuarit A.D., avokat nga M., lidhur me këtë shkelje fillimisht citon dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë për të theksuar se i njëjti është plotësisht i paqartë meqë nuk mund të kuptohet se si i dënuari ka sjell vetes apo tjetrit dobi të kundërligjshme apo i ka ndihmuar apo këshilluar të tjerët-kompanitë për mënyrën e shfrytëzimit të zhavorrit, duke mos specifikuar se cilat kompetenca i ka tejkaluar i dënuari, shkelje këto të cilat aktgjykimin e bëjnë të paqëndrueshëm. Më pas mbrojtësi thekson se veprimet e përshkruara në dispozitiv nuk mund të konsiderohen veprime të paligjshme sepse këto këshillime ishin në funksion të respektimit të vendimit të Ministrisë përkatëse.

Theksohet se gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë analizën e provave të administruara gjë që ka ndikuar që konkludimet e të dy gjykatave lidhur me fajësinë e të dënuarit të jenë të gabuara.

Pjesa tjetër e të dy kërkesave ka të bëjë me shkeljen e ligjit penal në dëm të të dënuarit. Mbrojtësit lidhur me këtë bazë juridike fillimisht citojnë dhe bëjnë analizën e dispozitës së nenit 422 të KPPK, për të theksuar se me asnjë provë nuk është

vërtetuar se në veprimet e të dënuarit është realizuar ndonjëra nga format e parapara të veprës të specifikuar në këtë dispozitë. Për më tepër mbrojtësi i të dënuarit A.D., me këtë mjet juridik nuk e konteston faktin se i dënuari ka dhënë udhëzime personave të caktuar por, cekë se kjo ka qenë për qëllime këshilluese për të respektuar vendimin e Qeverisë.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson si të bazuara pretendimet nga kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 1.12 e lidhur me nenin 70 të KPPK.

Fillimisht duhet theksuar se i dënuari R.L., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 442 par.1 të KPPK.

Në dispozitivin e aktgjyimit të shkallës së parë përshkrimi faktik i veprës penale është paraqitur në këtë mënyrë ..”gjatë periudhës kohore 2013-2014, në cilësi të inspektorit komunal të resurseve natyrore gjer më 24 prill 2014 në Kamenicë e pastaj nga data 25 prill 2014 në cilësi të përgjegjës të Inspektoratit Komunal në Kamenicë, me qëllim që vetit apo tjetrit t’i sjell dobi të kundërligjshme, në vazhdimësi ka keqpërdor pozitën apo autoritetin zyrtar duke i tejkualuar kompetencat e tij zyrtare, duke ndihmuar në forma të ndryshme kompanitë që merren me eksploatimin e rërës ... duke iu dhënë instruksione për eksploatimin ilegal të rërës dhe zhavorrit, duke i udhëzuar të njëjtat që të pajisen me dokumente fiktive doganore dhe të natyrave tjera si mbulesë për ushtrimin e veprimtarive të tyre dhe operimin e tyre në mënyrë ilegale e që ishin në kundërshtim me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.02/46 të datës 2 nëntor 2011...”

Kështu siç është ndërtuar dispozitivi i aktgjyimit të shkallës së parë nuk ka ndonjë përshkrim preciz dhe konkret të veprimeve inkriminuese të cilat i ka ndërmarrë i dënuari e që të do të ndërlidheshin me përgjegjësinë dhe detyrat e tij si person zyrtar.

Sipas përkufizimit ligjor të kësaj vepre penale, kjo vepër ekziston kur personi zyrtar apo personi përgjegjës, duke shfrytëzuar pozitën e vet zyrtare apo autorizimet, me tejkualimin e kufijve të autorizimeve të tij ose duke mos i kryer detyrat e veta zyrtare përfiton për vete apo për tjetrin çfarë do dobie, i shkakton dëm tjetrit ose shkel seriozisht të drejtat e personit tjetër. Për qëllime të këtij neni shpërdorimi i detyrës zyrtare përfshin por nuk kufizohet në: a) shkeljen me dashje apo me dijeni të ligjit lidhur me detyrat apo punësimin e zyrtarit; b) mos kryerja me dashje e ndonjë detyre të domosdoshme të përcaktuar me ligj; c) pranimi i dhuratës, tarifës apo përparësisë së çfarë do lloji si rezultat i kryerjes së detyrës zyrtare etj. Në përshkrimin e veprës penale në dispozitiv të aktgjyimit, nuk qëndron asnjë prej këtyre elementeve gjë që atë e bëjnë të pakuqteshëm.

Siç rezulton nga shkresat e çështjes, nuk ka qenë kontestues fakti se i dënuari R.L., është person zyrtar respektivisht përgjegjës në Inspektoratin Komunal në Kamenicë. Nuk ka qenë kontestues as fakti se i dënuari ka pasur korrespondenca telefonike me disa persona pronar të kompanive për eksploatimin e rërës dhe zhavorrit, që operojnë në regjionin e Gjilanit, mirëpo, i dënuari kategorikisht ka mohuar se këto korrespondenca kanë qenë të kundërligjshme por përkundrazi, të njëjtat i ka ndërmarrë në kuadër të zbatimit sa më efektiv të vendimit të Qeverisë për ndalimin e eksploatimit të rërës dhe të zhavorrit, madje ka theksuar se ai në kuadër të pozitës së tij, ka të drejtë të këshilloj persona të ndryshëm për procedurat e licencimit gjë që ka bërë edhe në rastin konkret.

Gjykata e shkallës së parë, vendimin e saj e bazon në provat e administruara, në radhë të parë përgjimet telefonike dhe dëshminë e dëshmitarit N.H. – komandant i Stacionit Policor në Kamenicë. Ky dëshmitar ka dëshmuar se në funksion të zbatimit të vendimit të Qeverisë nr.02/46 datë 2.11.2011, ka realizuar disa takime me inspektorët komunal ku ka qenë prezent edhe i dënuari R.L. Gjatë procesit lidhur me zbatimin e vendimit në fjalë policia ka hasur në pengesa në terren, meqë zyrtarët policor shpeshherë kanë ndaluar kamionët që transportonin zhavorr mirëpo, në shumicën e rasteve ata kanë ofruar dokumentet doganore DUD, se gjoja zhavorrin e kanë importuar nga Serbia. Kur ka kuptuar për këtë nga policët që punonin në terren, ka kërkuar që policia por edhe inspektorët, të përpilojnë procesverbalet për rastet kur kamionët janë liruar nga inspektorët komunal, në të cilat figurojnë emrat e policëve dhe inspektorëve - ekipit që zbatonin vendimin e Qeverisë së Kosovës. Por, ky dëshmitar nuk ka specifikuar emrat eventual të inspektorëve por, ka theksuar se të gjitha janë të shënuara në procesverbalet të cilët janë pjesë e shkresave të lëndës.

Në bazë të këtyre provave, Gjykata e shkallës së parë, lidhur me fajësinë e të dënuarit, konkludimin e saj ka paraqitur në këtë mënyrë: “ duke pasur parasysh deklaratën e dëshmitarit N.H... duke ju mundësuar që ta ushtrojnë veprimtarinë e tyre në kundërshtim me vendimin e Qeverisë, por edhe provat tjera të elaboruara, sidomos të përmbajtjes e transkriptove nga bisedat telefonike ... por edhe shkresave tjera, gjykata ka vërtetuar se i akuzuari në cilësi të përgjegjës të Inspektoriatit komunal në Kamenicë ka tejkaluar kompetencat e tij, duke ju ndihmuar në forma të ndryshme kompanitë të ndryshme sidomos kompanive të cekura në dispozitiv, duke ju dhënë instruksione për eksploatimin ilegal të materieve inerte, duke udhëzuar që të njëjtit të pajisen me dokumente fiktive doganore dhe të natyrave tjera për t'i bishtëruar Policisë ..e me këto veprime i ka siguruar dobi pasurore në mënyrë të kundërligjshme...”

Nga ky konkludim nuk mund të kuptohet se çfarë veprimesh konkrete i ka ndërmarr i dënuari, a ka qenë në terren me policët kur ata kanë kontrolluar kamionat me zhavorr, pra nëse dashja ishte përfitimi i kundërligjshëm apo për të “bishtëruar

Policinë” siç konkludon gjykata. Pra, këtu nuk kemi një situatë të qartë lidhur me faktet relevante sepse gjykata nuk ka dhënë arsye se përse konsideron se veprimet e përshkruara në dispozitiv si “ndihma në format e ndryshme dhe dhënia e instruksioneve” konsiderohen elementet qenësore të veprës penale nga neni 422 par.1 të KPPK e që nga përshkrimi i veprës penale nuk del që është kështu.

Arsyet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë ti cilat i ka konfirmuar edhe ajo e shkallës së dytë, lidhur me fajësinë e të dënuarit, nuk mund të pranohen nga kjo gjykatë. Për më tepër, provat janë paraqitur në mënyrë narrative pa ndonjë analizë kritike të tyre e në kuadër të kësaj edhe mbrojtja e të dënuarit.

Të gjitha këto aktgjykimin e bëjnë të pakuptueshëm dhe si të tillë juridikisht të paqëndrueshëm si me të drejtë pretendohet në kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Duke pasur parasysh faktin se shkeljet e konstatuara nuk i ka evituar gjykata e shkallës së dytë, edhe pse për këto shkelje kujdeset sipas detyrës zyrtare në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPK, edhe ky aktgjykim është i pa ligjshëm.

Në rigjykim, gjykata duhet të eliminoj shkeljet e konstatuara, të administroj të gjitha provat e propozuara si dhe provat tjera të cilat i konsideron të nevojshme për vërtetimin e drejt të gjendjes faktike, në veçanti duhet të vërtetohen faktet se si i dënuari këshilloj personat e cekur në aktgjykim, që të merren me eksploatimin ilegal të materieve inerte, kush i siguroj dokumentet e DUD-it, me iniciativën e kujt dhe çfarë kontributi ishte i të dënuarit në këtë punë si dhe a ishte i dënuari pjesë e ekipit të përbashkët me policët në terren, kur është lejuar kamionave që transportonin zhavorr, që të vazhdojnë rrugën, pasi që e më parë nga vozitësit iu kanë prezantuar dokumentet e DUD-it, e më pas të merr një aktgjykim të ligjshëm, me arsyet në harmoni me dispozitat e KPPK.

Nga sa u tha më sipër, kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë u aprovuan si të bazuara dhe në pajtim me dispozitën e nenit 438 par.1 pika 1.2 të KPPK, vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
Pml.nr.346/2017, më 2 prill 2018

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,
Nesrin Lushta